

## Kosova dhe Program Amerikan i Sistemit të Përgjithshëm të Preferencave (GSP)

### **Çka është sistemi GSP?**

Programi Amerikan i GSP promovon rritjen ekonomike në shtetet në zhvillim duke ofruar hyrje pa taksa në tregun Amerikan për produkte të importuara që vijnë nga shtetet e caktuara. Përafërsisht rreth 3,500 produkte nga Kosova janë të pranueshme për të hyrë në SHBA pa paguar taksa nën Programin e GSP. Bizneset Amerikane kanë importuar nën programin GSP, mallra me vlerë rreth 19.9 miliardë dollarë në vitin 2012, duke përfshirë 29,000 dollarë nga Kosova.

### **Cilat produkte janë të pranueshme për GSP?**

Shumë artikuj janë të pranueshëm për tajtimit pa taksa nën programin GSP. Këto përfshijnë: shumicën e artikujve të prodhar; inputet e përdorura për prodhim; stoli; shumë lloje të tepihëve; produkte të caktuara bujqësore dhe të peshkatarisë; dhe shumë lloje të kimikaleve, mineraleve, dhe mermerit. Ndër produktet që nuk janë të pranueshme për tajtimit pa taksa nën programin GSP janë shumica e produkteve të tekstilit dhe veshjeve; orat; dhe shumica e këpucëve, çantave, valixheve, dhe produkteve të lëkurës. Për më shumë informata rreth produkteve që janë të pranueshme për tajtimit pa taksa nën programin GSP vizitoni njërin ose të dyja webfaqet e mëposhtme:

- Për listën e kompletuar të artikujve të pranueshëm nën GSP të renditur sipas numrit të Agjendës së Harmonizuar të Taksave (USHTS): <http://www.ustr.gov/trade-topics/trade-development/preference-programs/generalized-system-preferences-gsp/gsp-program-i-0>.
- Për një databazë të kërkueshme: [http://dataweb.usitc.gov/scripts/tariff\\_current.asp](http://dataweb.usitc.gov/scripts/tariff_current.asp). Kjo databazë është e dobishme për ata persona që nuk janë në dijeni për numrin e Sistemit të Harmonizuar Amerikan të Taksave (HTS) që është i asociuar me një produkt. Pranueshmëria e një produkti në GSP mund të përcaktohet duke e futur emrin e produktit ose një përshkrim të shkurtër në kutinë e kërkimit dhe duke shtypur butonin "List Items." Një listë e numrave të HTS të asociuar me produktin do të shfaqen. Zgjedhni artikullin që më së shumti i përshtatet përshkrimit të produktit dhe klikoni butonin "Detail." Në faqen e detajeve, lëvizni poshtë te pjesa me titull "Preferential...tariff program applications." Programi i parë tregtar i preferuar që do të jetë i listuar është GSP. Nëse kutia e "Statutit" të GSP thotë: "Eligible: code A (ose A\*)" atëherë produkti është i pranueshëm për tajtimit pa taksa nën GSP.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Produktet "A" janë të pranueshme për tajtimit pa taksa nën GSP për të gjithë përfituesit; Produktet "A+" janë të pranueshme për GSP vetëm për shtetet më pak të zhvilluara pa e përfshirë Kosovën; Produktet "A\*" janë ato për të cilat shtete të caktuara përfituese nën GSP janë bërë të paparanueshme për tajtimitin pa taksa nën GSP; Në listë nuk ka kufizime A\* për importet që vijnë nga Kosova. Për Produkte të cilat nuk janë të pranueshme për tajtimitin pa taksa nën GSP do të shkruan "Not Eligible."

## Si mund t'a pranojnë importet nga Kosova trajtimin pa taksa nën GSP?

Një import i pranueshëm nën GSP duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- Duhet të jetë i përfshirë në listen e artikujve të pranueshëm për GSP;
- Duhet të jetë i importuar në SHBA direkt nga Kosova, pa hyrë në tregtinë e një shtetit tjetër;
- Duhet të jetë i rritur, prodhuar, ose produkt i Kosovës, me kosotn e materialeve Kosovare plus me qmim të procesimit të barabartë me së paku 35% të qmimit të shitjes së produktit:
  - Materialet e importuara mund të llogariten në minimumin e 35% vetëm nëse këto materiale i nënshtrohen një "transformimi të dyfishtë thelbësor" që do të thotë se artikulli i importuar transformohet në një artikull të rid he komplet ndryshe, i cili pastaj inkorporohet në një produkt të përfunduar në Kosovë;
- **MË E RËNDËSISHMJA:** Importuesi Amerikan duhet të kërkojë trajtimin pa taksa nën GSP duke vendosur "A" (ose "A\*", sipas nevojës) përpara numrit të Agjendës Amerikane të Taksave (HTSUS) i cili identifikon produktin e importuar në dokumentacionin e Doganave dhe Mrojtjes Kufitare të SHBA .

Prodhuesit dhe eksportuesit duhet të mbajnë regjistrime të cilat përshkruajnë procesin e prodhimit dhe koston e prodhimit të secilit produkt të eksportuar nën GSP. Doganat dhe Mbrojtja Kufitare e SHBA ka autoritetin për të pyetur një importues ose prodhues për t'i ofruar këto regjistrime për të vërtetuar që eksporti është i pranueshëm për trajtim pa taksa nën GSP.

### Rishikimet Vjetore

Rishikimet e programit GSP bëhen në periudha vjetore, gjatë të cilave palët mund të parashtrojnë kërkesa për të modifikuar listen e produkteve të cilat janë të pranueshme për trajtimin pa taksa nën programin e GSP, për të modifikuar statutin në GSP të disa shteteve përfituese nën GSP, për shkak të praktikave të tyre, dhe për të kërkuar heqjen e kufizimeve të nevojshme konkurruese (CNL). Rishikimi i ardhshëm vjetor o të niset në Korrik të vitit 2013.

### Për më shumë informata:

Udhëzues për GSP: <http://www.ustr.gov/trade-topics/trade-development/preference-programs/generalized-system-preference-gsp>

Sistemi Amerikan i Harmonizuar për Taksa: [www.usitc.gov/tata/hts](http://www.usitc.gov/tata/hts)

Lista e produkteve të pranueshme nën GSP: <http://www.ustr.gov/trade-topics/trade-development/preference-programs/generalized-system-preferences-gsp/gsp-program-i-0>